Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Anita Balaj	**23.05.2023**	**01.06.2023**	**2023/0294**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 22.05.2023, OE "EUROPRINT GROUP SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0294, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me Material Shpenzues per Zyre - Ritender 3" me nr. të prokurimit: "214-23-2825-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 11,616.95 €.

- Njoftimi për kontratë ----------29.03.2023
- Procesverbali i hapjes së ofertave----------13.04.2023
- Njoftim mbi vendimin e AK----------04.05.2023
- Kërkesë për rishqyrtim tek AK----------06.05.2023
- Vendim mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim-----11.05.2023
- Ankesa në OSHP----------22.05.2023

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Shkeljet e dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92, (LPP), janë:

- Neni 1 - Qëllimi
- Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
- Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Autoriteti Kontraktues- Policia e Kosovës me datën 29.03.2023, në platformën e e-prokurimit ka bere publikimin e Njoftimit për Kontrate dhe Dosjen e Tenderit për aktivitetin me numër të prokurimit: 214-23-2825-121- Furnizim me Material Shpenzues për Zyre –Ri-tender 3 Në me datën 13.04.2023, përmes platformës së e-prokurimit kemi dërguar të AK- Oferten se bashku me të gjitha dokumentet dhe mostrat e te gjithë artikujve sipas kërkesave të AK, të paraqitura në Njoftimin për Kontrate dhe Dosjen e Tenderit. Gjatë fazës së vlerësimit, AK, përmes platformës së E-Prokurimit me datën 14.04.2023 na dërgon Formularin B47- Letër Standarde e Kërkesës për Sqarime të Tenderit ku përmes këtij formulari kërkon, qe të sqarojmë me deklarate me shkrim se mostra e dorëzuar për artikullin 4- Makine për shpuarjën e letrës, përmban opsionet për rregullimin e formateve te shpuarjës duke filluar nga formati (A4,A5,A6)- Dëshmia nr. 1- Formularin B47- Letër Standarde e Kërkesës për Sqarime të Tenderit e datës 14.04.2023;

Ne me datën 18.04.2023 përmes platformës së E-Prokurimit kemi dërguar të AK, Përgjigjen ashtu siç ka kërkuar AK në kërkesën e tyre të datës 14.04.2023, ku i kemi informuar se mostra e dorëzuar MAKINE PER SHPUARJE TE LETRES me 2 vrime përmban opsionet për rregullimin e formateve te shpuarjës duke filluar nga formati (A4 , A5 , A6). Dëshmia nr. 2- Përgjigjja ne forme të Deklaratës e datës 18.04.2023; Autoriteti Kontraktues prape me datën 24.04.2023, përmes platformës së E-Prokurimit na dërgon Formularin B47- Letër Standarde e Kërkesës për Sqarime të Tenderit, ku tani përmes këtij formulari kërkon sqarime lidhur me çmimet e artikujve nr. 4, nr. 14 dhe nr. 20. Gjithashtu për këta tre artikuj kërkon që të ju dërgojmë dëshmi lidhur me çmimet e tregut. Dëshmia nr. 3- Formularin B47- Letër Standarde e Kërkesës për Sqarime të Tenderit e datës 24.04.2023;

Ne me datën 26.04.2023 përmes platformës së E-Prokurimit kemi dërguar të AK, Përgjigjen ashtu siç ka kërkuar AK në kërkesën e tyre të datës 24.04.2023, ku i kemi informuar ne lidhje me çmimet e tri pozicioneve te shënuara me larte e për të cilat Zyrtaret e AK, kane pretenduar se janë çmime me te larta se çmimet e tregut. Gjithashtu i kemi informuar se çmimet e këtyre tre artikujve dhe të gjithë artikujt tjerë qe kemi ofertuar ne ketë tender janë çmime reale të tregut bazuar në specifikat teknike që AK ka paraqitur ne Dosje te Tenderit për këta artikuj. Dëshmia nr. 4- Përgjigjja në forme të Deklaratës e datës 26.04.04.2023; Për të ju dëshmuar Zyrtareve të AK , që çmimet e tri pozicioneve të shënuara me larte janë çmime reale të tregut së bashku me përgjigjen ju kemi dërguar edhe këto dëshmi: Për artikullin nr. 4- Makine për shpuarje të letrës, kemi dërguar linqet e katër prodhueseve të ndryshme që prodhojnë ketë lloj të makinave shpuese:

https://www.legalstore.com/Extra-Heavy-Duty-100-Sheet-2-Hole-Paper-Punch-p/cui62100.htm

https://www.homenoffice.sg/basic-stationery/staplers-and-paper-punches/carl- 120-heavy-duty-2-hole-punch-145-sheets

https://www.officensupplies.com/shop/Carl-Heavy-Duty-2-Hole-Punch-HD120

https://www.amazon.com/dp/B0013CFWRK/ref=sspa_dk_detail_5?

Për artikullin nr. 14- Kapëse të metalit, e plastifikuar për kapjen e letrave, kemi dërguar linket e tre prodhueseve të ndryshme qe prodhojnë ketë lloj të kapëseve të metalit:

https://www.hepsiburada.com/cassa/masa-ustu-gerecleri-c-15547?sayfa=2

https://www.hepsiburada.com/sdi-renkli-atas-33-mm-kutulu-100-luk-pm-HB0000145BJ6

https://www.trendyol.com/f3-market/100-adet-renkli-atas-atac-32mm-p-87025979

Për artikullin nr. 20- Fasikell plastike kemi dërguar linkun e një prodhuesi qe prodhonë ketë lloj të Fasikellave plastike :

https://www.amazon.com/Eco-Friendly-Expanding-Envelope-Waterproof□Organization/dp/B07JHC16G8?th=1

Gjithashtu se bashku me përgjigjen që kemi dërguar të AK me datën 26.04.2023, për të qene edhe ma bindes që çmimet me te cilat kemi ofertuar janë çmime reale të tregut , ju kemi dërguar AK edhe faturën, Nr. 29-210-004-23 të datës 03.04.2023 të Furnizuesit tone Media Tech Print ku në ketë fature janë te shënuara edhe tre artikujt e njëjte që kemi ofertuar ne ketë tender ne Policinë e Kosovës e për të cilët Zyrtaret e AK-Policisë se Kosovës pretendojnë se janë çmime shume të larta. Dëshmia nr. 5- Fatura Nr. Nr. 29- 210-004-23 e datës 03.04.2023; Fatkeqësisht Zyrtaret e AK – Policisë së Kosovës në vende që të veprojnë Konforme legjislacionit të prokurimit publik të aplikueshëm në Republikën e Kosovës dhe të na shpërblejnë me kontrate si ofertën me çmimin me te lire prej 9,661.75 € , veprojnë krejt në të kundërtën dhe na eliminojnë nga aktiviteti i prokurimit. AK- Policia e Kosovës , me datën 04.05.2023, publikon ne platformën e E-Prokurimit Formularin B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues- Anulim të aktivitetit të prokurimit dhe Letrat Standarde për Tenderuesit e Eliminuar. Në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar të kompanisë tone vete, AK-Policia e Kosovës ka shënuar së Operatori Ekonomik – " Europrinty Grpup" i plotëson të gjitha kërkesat e Dosjes se Tenderit dhe Njoftimit për Kontrate.

Për ti dhëne mundësi AK-Policisë se Kosovës qe shkeljet ligjore qe ka bere me rastin e vlerësimit të ofertave ti përmirësoj, ne me datën 06.05.2023, përmes platformës së E□Prokurimit kemi dërguar të AK-Policia e Kosovës , Kërkesën për Rishqyrtim, ku i kemi cekur të gjitha shkeljet që AK ka bere me rastin e vlerësimit të ofertave dhe eliminimit tone nga aktiviteti i prokurimit. AK-Policia e Kosovës ne vende qe të shfrytëzoj rastin dhe përmirësoje shkeljet substanciale të legjislacionit të prokurimit publik të bëra gjate fazës së vlerësimit të ofertave, dhe të na aprovoj Kërkesën tone për Rishqyrtim si plotësisht të bazuar, AK , pa bere asnjë hulumtim të tregut për artikuj qe ka pretenduar së janë me çmime me të larta se çmimet e tregut tek dëshmitë te cilat ja kemi dërguar ne gjate fazës se vlerësimit të ofertave , pa bere asnjë hulumtim të tregut në shitoret qe merren me shitjen e këtyre artikujve, (qe vetëm në Prishtine janë mbi 100),por duke u bazuar vetëm në çmimet spekuluese për njësi të artikujve qe Njësia e Kërkesës me qellim të spekulimit i ka planifikuar, me datën 11.05.2023 merre vendim që Kërkesën tone për Rishqyrtim ta konsideroj si te pa bazuar. Duhet theksuar së vete AK-Policia e Kosovës në Njoftimin për Kontrate dhe në Dosje të Tenderit ka shënuar së vlera e parashikuar për ketë aktivitet të prokurimit është 11,616.95 € , qi i bie së oferta e jone është për 1,995.20 € (shprehur ne përqindje 16.83 %) me e lire se vlera

e parashikuar nga vete Autoriteti Kontraktuese. Gjithashtu duhet theksuar AK ketë aktivitet të prokurimit e ka zhvilluar duke përdorur Dosjen e Tenderit – Kontrate Publike – Furnizim – Procedurë e Hapur, që nënkupton së te gjithë artikujt dhe të gjitha sasitë e tyre me të cilët kemi ofertuar, duhet të liferohen - dorëzohen të AK, brenda 20 dite nga data e nënshkrimit të kontratës. Prandaj AK nuk ka pasur asnjë bazë ligjore që të na eliminoj nga aktiviteti i prokurimit ,ta beje Anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit dhe të na refuzoje Kërkesën për Rishqyrtim.

Nëse nisëm nga kjo logjike skandaloze e Zyrtareve të AK-Policisë se Kosovës, që çdo herë kur kemi çmime për njësi të artikujve në ofertat e OE me të larta së çmimet për njësi të artikujve të planifikuara nga Njësia e Kërkesës, pa marre parasysh që kontrata është Kontrate Publike për një furnizim dhe vlera totale e ofertave te OE është me e lire se vlera e parashikuar e AK, atëherë çdo aktivitet i prokurimit që zhvillohet në Kosove , duhet të anulohet. Si ka mundësi që OE të ofertojnë vetëm me çmimet për njësi të artikujve të cilët AK – Njësia e Kërkesës i ka planifikuar, sidomos kur AK-Njësite e Kërkesës nuk bëjnë asnjë hulumtim të tregut por bazohen vetëm ne çmimet për njësi të kontratave të tyre paraprake, siç është rasti tani me AK-Policinë e Kosovës. Vete fakti që Zyrtaret Përgjegjës të AK- Policisë së Kosove që katër here e anulojnë ketë aktivitet të prokurimit, dëshmon së qëllimi i këtyre Zyrtareve, është që të anulojnë ketë aktivitet të prokurimit deri sa të fitojë OE i preferuar nga këta Zyrtare. Nga të gjitha këto që i cekem me larte dhe dëshmitë që ja bashkangjesim kësaj ankese shume qarte shihet së Autoriteti Kontraktues-Policia e Kosovës gjate zhvillimit të këtij aktiviteti te prokurimit ka bere shkelje substanciale te LPP- nenit Neni 1 - Qëllimi, Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve. Bazuar në të gjitha të dhënat e shënuara me larte në ketë Ankese, dëshmitë e bashkangjitura kësaj ankese dhe dokumentacionin e këtij aktiviteti të prokurimit, kërkojmë nga Paneli Shqyrtuese i OSHP-së, që kërkesa jonë të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe tenderin ta ktheje ne Ri-vlerësim.

KRITERET PËR VLERËSIM

Përshkrimi i çmimit

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

'ërejtje përmbyllëse në lidhje me vlerësimin e tenderëve të përgjegjshëm:

:omisioni i vlerësimit pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave për këtë aktivitet i pr
ranuar tri (3) oferta, komisioni vlerësues rekomandon si në vijim: Anulohet për shkak se të gjitha
anë ofertuar me çmime me te larta se tregu/ vlerës se parashikuar për secilin artikull nga Njësia Ke

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **EUROPRINT GROUP SH.P.K.**

Sqarim Hyrës: Bazuar në rrjedhen e AP dhe dokumenteve të publikuara në platformen elektronike e-prokurimi, AK ka publikuar njoftimin për kontratë më datë 29.03.2023 dhe me datë 13.04.2023 është bërë hapja e ofertave të dorëzuara për këtë AP. AK me datë 04.05.2023 ka publikuar njoftim mbi vendimin e AK për anulimin e aktivitetit të prokurimit. OE me datë 06.05.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim tek AK dhe me datë 11.05.2023 AK ka publikuar vendim mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim. OE ankues me datë 22.05.2023 ka paraqitur ankesë pranë OSHP-së.

Pretendimi 1: OE pretendon që është eleminuar pa të drejtë nga AK lidhur me çmimin për artikujt nr.4, 14 dhe 20. AK nuk ka pasur asnjë bazë ligjore që të na eliminoj nga aktiviteti i prokurimit ,ta beje Anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit dhe të na refuzoje Kërkesën për Rishqyrtim. Nëse nisëm nga kjo logjike skandaloze e Zyrtareve të AK-Policisë se Kosovës, që çdo herë kur kemi çmime për njësi të artikujve në ofertat e OE me të larta së çmimet për njësi të artikujve të planifikuara nga Njësia e Kërkesës, pa marre parasysh që kontrata është Kontrate Publike për një furnizim dhe vlera totale e ofertave te OE është me e lire se vlera e parashikuar e AK, atëherë çdo aktivitet i prokurimit që zhvillohet në Kosove , duhet të anulohet. Si ka mundësi që OE të ofertojnë vetëm me çmimet për njësi të artikujve të cilët AK – Njësia e Kërkesës i ka planifikuar, sidomos kur AK-Njësite e Kërkesës nuk bëjnë asnjë

hulumtim të tregut por bazohen vetëm ne çmimet për njësi të kontratave të tyre paraprake, siç është rasti tani me AK-Policinë e Kosovës.

Përgjigjje në pretendimin 1: Duke u bazuar në kriteret e njoftimit për kontratë dhe FDT e publikuara për këtë aktivitet të prokurimit, AK për këtë aktivitet të prokurimit ka parashikuar Afatin kohorë për përfundim 20 ditë nga dhënia e kontratës me vlerë të parashikuar 11,616.95€ dhe si kriter të dhënies çmimi më i ulët. Pra AK në këtë AP nuk e ka cekur që si kriter i vlerësimit janë çmimet për njesi. **Ekspertja shqyrtuese sqaron** se AK është i obliguar që para inicimit të një aktiviteti të prokurimit të veproj sipas nenit 13 paragrafi 13.1 i Rregullores nr.001/2022 për prokurim publik: *13.1 Vlera e parashikuar e një kontratë publike duhet të parallogaritet para inicimit të procedurës së prokurimit. Parallogaritja e tillë duhet të jetë e arsyeshme dhe reale për kontratën e parashikuar. Në parashikimin vlerës së kontratës AK është përgjegjës për krahasimin e çmimeve të tregut, çmimeve të kontratave paraprake kur ato ekzistojnë, etj, me analizë të kostos të specifikimeve relevante teknike të mallrave, shërbimeve ose punëve për prokurim.* Po ashtu AK lidhur më këtë AP duhet të veproj edhe në pajtim me nenin 16 paragrafi 1 i LPP-së :*Vlera e parashikuar e kontratës së propozuar për furnizim duhet të jetë e barabartë me çmimin përfundimtar që duhet të paguhet nga autoriteti kontraktues për të gjitha produktet, shërbimet dhe objektet e tjera që përfshihen në një kontratë të tillë. Çmimi i parashikuar i produkteve, shërbimeve dhe objekteve është çmimi i parashikuar i tyre në ditën e dërgimit të njoftimit të kontratës lidhur me to. Gjatë përcaktimit të vlerës së parashikuar të një kontrate të propozuar për furnizim, autoriteti kontraktues do t'i përfshijë të gjitha elementet e çmimit përfundimtar që mund të parashikohen në mënyrë të arsyeshme, që do të paguhet nga autoriteti kontraktues për produktet, shërbimet dhe lëndët e tilla, duke përfshirë çfarëdo dhe të gjitha taksat, doganat dhe tarifat e tjera.*

Ekspertja shqyrtuese sqaron se bazuar në raportin e vlersimit të tenderëve dhe njoftimit mbi vendimin e AK me anën e të cilëve OE ankues e klasifikojnë si OE i cili i ka plotësuar të gjitha kriteret e njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit por vetem për artikujt nr. 4, 14, 20 kanë dhënë çmime më të larta se çmimet e tregut, dhe duke marr parasysh kriteret e publikuara në njoftimin për kontratë dhe FDT nga AK në të cilat nuk është cekur që kriter i vlersimit janë çmimet për njesi, si dhe pas analizimit të ofertës financiare të OE ankues i cili ka ofertuar me çmim total 9,661.75€ vlerë e cila është më e ulët se vlera e parashikuar për kontratë, pretendimi i OE ankues është **i bazuar.**

Pretendimi 2: Sipas OE ankues AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka bërë shkelje të nenit 1, nenit 6, nenit 7 dhe nenit 59 të LPP-së.

Pergjigjje në pretendimin 2: Ekspertja shqyrtuese sqaron se AK është i obliguar që gjatë zhvillimit të të gjitha aktiviteteve të prokurimit të respektoj legjislacionin në fuqi të prokurimit publik, AK është i obliguar që fondet publike ti përdor në mënyrën më të drejtë, transparente dhe në mënyrë ekonomike. Sa i përket nenit 7 të LPP-së, AK nuk ka bërë shkelje të këtij neni pasi të gjithë OE të cilët kanë ofertuar në këtë AP i ka trajtuar njejtë dhe nga të gjithë ka kërkuar sqarim për çmimet e artikujve të caktuar. Ndërsa lidhur me neni 59 të LPP-së AK është i obliguar që ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve ta bëj konform këtij neni.

Ekspertja shqyrtuese konsideron se lënda duhet të kthehet në ri-vlersim dhe të veprohet sipas kritereve të njoftimit për kontratë dhe dosjes se tenderit si dhe konform legjislacionit në fuqi për prokurim publik.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **EUROPRINT GROUP SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA

Anita Balaj